



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 293 Akti

Nr. 324 Vendimi
Tiranë, më 11.12.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 9.12.2020, ora 09:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Sokol Ngresi**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.3.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 18.3.2019 u caktua, me mirëkuptim, kryesuese e trupit gjykues komisionere Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Steven Kessler.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).

5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar².

7. KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë

¹ Raport dërguar me shkresën nr. **** prot., datë 24.7.2018.

² Me shkresën nr. **** prot., datë 3.2.2020, dërgohet raporti i DSIK-së, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 28.2.2020, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. **** prot., datë 27.12.2019.

dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 23.11.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Për një proces të rregullt ligjor, z. Sokol Ngresi i janë garantuar të drejtat, si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërja e trupit gjykues; si dhe njoftimi për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Në datën 23.11.2020, për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit, subjektit iu dhanë 10 ditë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

11. Z. Sokol Ngresi, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij në datën 3.12.2020. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 23.11.2020.

13. Seanca dëgjimore u zhvilluan në datën 9.12.2020, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

14. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19. Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGj-ja;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, u krye mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore; burimet e krijimit të kësaj pasurie; të ardhurat; shpenzimet; mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konfliktin e interesit.

A/1. Hetimi i kryer nga Komisioni

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI më 27.1.2017, në zbatim të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti ka deklaruar:

1. Apartament banimi⁴ me sipërfaqe 144.8 m², në Vlorë. Pjesa takuese: në bashkëpronësi me bashkëshorten.

Burimi i krijimit: (i) me kredi në “Raiffeisen Bank”, në shumën 30.000 euro, në vitin 2012; (ii) kredi e marrë në NBG në shumën 16.000 euro në vitin 2007; (iii) kursime të grumbulluara në vite në shumën 19.160 euro.

Deklarimi në DPV: në DPV-në e vitit 2012 është deklaruar burimi i krijimit për këtë pasuri: (i) kredi nga “Raiffeisen Bank” në shumën 30.000 euro; (ii) kursime të grumbulluara në vite në shumën 20.000 euro.

Mënyra e fitimit: me kontratë porosie nr. *** rep., datë 13.11.2012, me shoqërinë ndërtuese “Ç” sh.p.k. dhe me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., datë 23.3.2015.

1.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- kontratë porosie (ndërtim e blerje apartamenti) nr. **** rep., nr. **** kol., data 13.11.2012, me cilësinë e palës së porositur z. F. Ç dhe cilësinë e palës porositëse Sokol Ngresi dhe L. N, për shitjen e një apartamenti të ndodhur në katin e ** të objektit të emërtuar AP. 1 ** (***) me sip. totale 144.8 m² kundrejt vlerës 65.160 euro. Palët kanë renë dakord që kjo shumë të likuidohet në këtë mënyrë: vlera prej 20.000 euro do të likuidohet nga pala porositëse brenda datës 13.11.2012;
- fotokopje të kartave të indentitetit të shtetasve Sokol dhe L.N; planimetri apartamenti; fotokopje e prokurës së posaçme datë 16.10.2008;
- kontratë kredie bankare dhe hipoteke nr. *** rep., nr. **** kol., datë 27.12.2012, me palë kredidhënëse “Raiffeisen Bank” dhe palë kredimarrëse L.N dhe bashkëkredimarrës Sokol Ngresi, në shumën 30.000 euro për blerje shtëpie;
- kontratë shitje (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.3.2015 me palë shitëse shoqërinë ndërtuese “Ç” sh.p.k. dhe palë blerëse Sokol dhe L. N, të apartamentit me nr. pasurie *****N***, z. k. *****, vol. ***, f. ***. Me indeks harte VL-N-** me sipërfaqe totale ndërtimi 144.8 m² në Vlorë. Vlera totale prej 65.160 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale me këste sipas dokumenteve bashkëngjitur e gjithë shuma në fjalë;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, datë lëshimi 3.3.2015, ZVRPP Vlorë, z. k. **** për pasuri nr. **N**, vol. **, f. ***, lloji apartament me sip. 136.90 m² në pronësi të shoqërisë “Ç” sh.p.k.; kartela e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit;
- mandatarëtimi nr. **, datë 14.11.2012, arkëtuar nga shtetasit Sokol dhe L.N, shuma 20.000 euro për prenotim apartamenti me sip. 144.8 m² te shoqëria “Ç”;
- mandatarëtimi nr. **, datë 22.2.2015, arkëtuar nga shtetasi Sokol Ngresi, shuma 8.000 euro për likuidim kësti apartamenti ndaj shoqërisë “Ç”;
- mandatarëtimi nr. **, datë 18.12.2014, arkëtuar nga z. Sokol Ngresi, shuma 7.160 euro për likuidim kësti apartamenti ndaj shoqërisë “Ç”;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë lëshimi të certifikatës 25.3.2015, ZVRPP Vlorë, z. k. ***, pasuri nr. *****N**, vol. **, f. ***, lloji apartament me sip. 136.90 m² në pronësi të shtetasve L dhe S.N; kartela e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit;
- kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.10.2007 me palë kredidhënëse Banka Kombëtare e Greqisë dhe palë kredimarrëse Sokol dhe L.N të shumës 16.000 euro me qëllim blerjen e një apartamenti me adresë lagjja “*****” Vlorë. Pjesëmarrja e kredimarrësve në këtë investim është në shumën 17.000 euro; dorëzanës Th dhe A. N me pasurinë nr. ***, vol. *, f. ***, lloji apartament me sip. 49.76 m² në Vlorë;
- certifikatë për vërtetim pronësie me datë lëshimi 1.3.2007, ZVRPP Vlorë, z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. *, f. ***, lloji apartament me sip. 49.76 m² në Vlorë, në pronësi të shtetasit Th.N; kartela e kësaj pasurie;
- kërkesë për transferim fondesh datë 25.10.2007 në NBG ku shtetasi Sokol Ngresi transferon shumën 15.679 euro, si pagesë për blerje apartamenti për shoqërinë “V” sh.p.k.;
- veprim banke datë 25.10.2007, për transferimin e shumës 15.711 euro, si pagesë për blerje apartamenti nga z. Sokol Ngresi për shoqërinë “V” sh.p.k.;
- kërkesë datë 30.3.2010, drejtuar NBG dega Vlorë, nga shtetasit Th, A dhe S.N për lejimin e dhurimit të apartamentit që është vendosur në hipotekë, si garanci për kredinë e z. Sokol Ngresit, marrë në NBG në shumën 16.000 euro;
- nxjerrje llogarie nga NBG-ja ku figurojnë iveditimet e vlerës 16.000 euro, datë 9.10.2007 dhe transferimin e vlerës 15.711 euro, datë 25.10.2007;
- nxjerrje llogarie nga NBG-ja për periudhën 2009 – 2012, ku figurojnë veprimet e pagesave të kësteve të kredisë;
- konferma bankare nga NBG-ja datë 29.10.2012, për pagesë komisioni në vlerën 420 euro nga shtetasi Sokol Ngresi;
- mandatarëtimi/depozitë për mbyllje kredie datë 29.10.2012, në shumën 3.197 euro;
- kërkesë për transferim fondesh midis dy llogarive, NBG, datë 22.10.2012 nga shtetasi Sokol Ngresi për transferimin e shumës 150.65 euro; veprim banke datë 29.10.2012 për transferimin e shumës 150.65 euro, për shtetasit Th.N nga Sokol Ngresi; veprim banke datë 29.10.2012, për debitimin e shumës 150.65 euro nga shtetasi Sokol Ngresi;
- vërtetim datë 24. 1. 2017, nga NBG-ja, nëpërmjet të cilit vërtetohet se shtetasi Sokol Ngresi ka pasur një kredi për blerje shtëpie në shumën 16.000 euro të akorduar që prej datës 9.10.2007. Kredia është shlyer në datën 29.10.2012. Klienti nuk ka asnjë detyrim ndaj kësaj banke;
- deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. **** kol., datë 1.11.2012, mes Bankës Kombëtare të Greqisë dhe shtetasës M.M në cilësinë e RSM Dega Vlorë, për çregjistrimin e bllokimit të bërë mbi pasurinë nr. ***, vol. *, f. ***, për kontratën e kedisë datë 1.10.2007, marrë nga z. Sokol Ngresi.

ASHK-ja Drejtoria Vendore Vlorë⁵ ka konfirmuar se në emër të shtetasve Sokol dhe L.N figuron e regjistruar pasuria nr. *****NI *, z. k. ***, vol. **, f. ***, lloji i pasurisë apartament në Vlorë.

“**ABI Bank**”⁶ (banka që ka përthithur NBG-në) ka konfirmuar se subjekti ka marrë një kredi në shumën 16.000 euro, në datën 9.10.2007, të cilën e ka shlyer në vitin 2012.

“**Raiffeisen Bank**”⁷ ka konfirmuar se subjekti dhe bashkëshortja kanë marrë një kredi në shumën 30.000 euro, në datën 27.12.2012. Nga aktet e dosjes rezulton një kontratë kredie bankare dhe hipotekore me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.12.2012, nëpërmjet së cilës “Raiffeisen Bank” i ka disbursuar shtetasve Sokol dhe L.N një kredi në shumën 30.000 euro, për blerje shtëpie, për një afat 109 muaj.

1.2 Komisioni ka verifikuar burimet e krijimit të pasurisë apartament, si vijon:

Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se burimet e krijimit për këtë pasuri janë: kredia në shumën 30.000 euro në “Raiffeisen Bank”; kredi në shumën 16.000 euro në NBG; kursime të grumbulluara në vite në shumën 19.160 euro. Në DPV-në periodike të vitit 2012 ka deklaruar si burim: kredinë nga “Raiffeisen Bank” në shumën 30.000 euro dhe kursime të grumbulluara në vite në shumën 20.000 euro.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit së përse shuma prej 16.000 euro, e përfituar me anë të kredisë bankare me destinacion blerjen e një apartamenti prej sipërmarrësit “V” sh.p.k., e vitit 2007, deklarohet prej tij si burim për krijimin e pasurisë apartament banimi me sip. 144.8 m² e blerë prej sipërmarrësit “Ç” sh.p.k. në vitin 2015.

Subjekti ka argumentuar⁸ se: *“Shuma prej 16.000 euro, e përfituar me anë të kredisë bankare me destinacion blerjen e një apartamenti prej sipërmarrësit ‘V’ sh.p.k. e vitit 2007, e cila nuk është përdorur më tej, por është disponuar prej meje cash, është deklaruar nga ana ime si një pjesë e burimit për krijimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqje 144.8 m², e blerë prej sipërmarrësit ‘Ç’ sh.p.k., në vitin 2015. Pavarësisht së kjo kredi është shlyer tërësisht nga unë dhe bashkëshortja ime, pra në thelb është pjesë e të ardhurave të mia, e kam identifikuar si të tillë për të qenë transparent dhe për të evidentuar burimin e kësaj shume në çastin e krijimit të saj dhe mënyrën e përdorimit përfundimtar të kësaj shume”*.

1.3 Analiza e fakteve

Nga verifikimi i akteve ka rezultuar së ndërmjet subjektit dhe shoqërisë së ndërtimit “Ç” sh.p.k., është nënshkruar një kontratë porosie me nr. **** rep., nr. *** kol., datë 13.11.2011, për porositjen e një apartamenti me sip. 144.8 m², në çmimin 65.160 euro. Palët kanë rënë dakord që kjo shumë të likuidohet sipas kushteve vijuese:

- vlera 20.000 euro do të likuidohet nga pala porositëse brenda datës 13.11.2012;
- vlera prej 45.160 euro do të likuidohet nga pala porositëse nëpërmjet bankës brenda datës 30.6.2013.

Nga aktet rezulton se shuma prej 30.000 euro ka kaluar nga llogaria e znj. L. N në llogarinë e shoqërisë “Ç” sh.p.k., në datën 27.12.2012.

Gjithashtu palët, në datën 23.5.2015, kanë nënshkruar kontratën e shitjes (për pasuri të paluajtshme) nr. *** rep., nr. **** kol., datë 23.3.2015, me shitës shoqërinë ndërtuese “Ç” sh.p.k.,

⁵ Me shkresën nr. **** prot., datë 23.10.2019.

⁶ Me shkresën nr. **** prot., datë 14.10.2019.

⁷ Me shkresën nr. **** prot., datë 8.10.2020.

⁸ Me përgjigjet e pyetësorit të datës 2.12.2019.

dhe blerës shtetasit Sokol dhe L. N, të apartamentit me sipërfaqe totale ndërtimi 144.8 m², me nr. pasurie ***-N**, z. k. ***, vol. **, f. ***, në Vlorë. Vlera totale e pronës është 65.160 euro. Palët deklarojnë se shuma e blerjes është likuiduar jashtë zyrës noteriale me këste sipas dokumenteve bashkëlidhur. Bashkëlidhur kontratës së shitblerjes ka rezultuar:

- mandatarkëtimi nr. **, datë 14.11.2012, me përshkrimin: arkëtuar nga Sokol dhe L.N shuma prej 20.000 euro, për prenotim apartamenti me sip. 144 m²;
- mandatarkëtimi nr. **, datë 19.12.2012, arkëtuar nga shtetasit Sokol dhe L.N, shuma 5.160 euro, për prenotim apartamenti me sip. 144.8 m² te P;
- dokument njoftim debitimi me urdhërues znj. L. N, datë 27.12.2012, me detaje pagesë “kalim fondi për blerje apartamenti”, në shumën 30.000 euro, me përfitues shoqëria “Ç” sh.p.k.;
- dokument i “Raiffeisen Bank” “depozitim në llogari personale”, datë 15.5.2013 me përshkrim veprimi: F. Ç derdh shlyerje pjesore të S. N., shumën prej 10.000 euro;
- mandatarkëtimi nr. **, datë 18.12.2014, me përshkrimin: arkëtuar nga z. Sokol Ngresi shuma prej 7.160 euro, për likuidim apartamenti;
- mandatarkëtimi nr. ***, datë 22.2.2015, me përshkrimin: arkëtuar nga z. Sokol Ngresi shuma prej 8.000 euro, për likuidim apartamenti.

Sipas këtyre mandatpagesave rezulton se subjekti ka paguar shumën prej 70.320 euro dhe jo sa është parashikuar në kontratë dhe sa është deklaruar prej tij.

Subjekti u pyet dhe në përgjigjet të pyetësorit⁹ ka shpjeguar se: “Për fitimin e pronësisë së apartamentit me sipërfaqe 144.8 m² kam paguar çmimin e përcaktuar në kontratë në shumën 65.160 euro. Pagesat janë kryer me mandatarkëtimin nr. **, datë 14.11., në vlerën 20.000 euro për prenotimin e këtij apartamenti, një pjesë e çmimit në vlerën 30.000 euro është paguar me kredinë e marrë pranë ‘Raiffeisen Bank’ sh.a., me mandatarkëtimin nr. **, datë 18.12.2014 është evidentuar pagimi i shumës prej 7.160 euro dhe me mandat nr. *** datë 22.4.2015 është evidentuar pagimi i shumës prej 8.000 euro.

E gjithë vlera e këtij apartamenti e paguar prej meje dhe bashkëshortes sime është ajo e sipërcituar, në shumën 65.160 euro. Në lidhje me mandatarkëtimin nr. ** datë 19.12.2012, ku citohet ‘arkëtuar nga Sokol dhe L. N, shuma 5.160 euro, për prenotim apartamenti 144.8 m² te P’, ju bëj me dije së është një lapsus nga ana e shoqërisë ndërtuese ‘Ç’ sh.p.k., në plotësimin e këtij mandatarkëtimi, në rubrikën ku është evidentuar arkëtuesi, pasi kjo pagesë nuk është kryer për llogari të apartamentit të prenotuar prej meje dhe bashkëshortës sime, prej 144,8 m², por është pagesa e një kësti për apartamentin prej 89 m², e kryer nga nëna ime A.N, për blerjen prej saj të këtij apartamenti, në të njëjtin pallat dhe pranë të njëjtës shoqëri ndërtuese. Këtë shumë e ka arkëtuar nëna ime dhe për shkak të moshës së saj, ishim unë dhe bashkëshortja që ndiqnim ecurinë e kontratës, ndaj edhe ka ndodhur ky lapsus në plotësimin e këtij mandatarkëtimi.

Siç rezulton nga data e këtij mandati, ai është lëshuar një muaj pas mandatarkëtimin nr. ** datë 14.11.2012, në vlerën 20.000 euro dhe të dy këto mandate bëjnë fjalë ‘për prenotim apartamenti’, ndërkohë që pagesa e vetme në çastin e prenotimit të apartamentit me sipërfaqe prej 144.8 m², është ajo e kryer me mandatin nr. ** datë 4.11.2012. Për shkak se si nga ana ime dhe bashkëshortes, ashtu edhe nga nëna ime A. N, me dorëzimin e apartamenteve janë likuiduar tërësisht këstet e tjera të çmimit, duke u pranuar ky fakt edhe nga shoqëria ndërtuese, nuk është bërë korrigjimi i mandatarkëtimin nr. ** datë 19.12.2012, që e ritheksoj, është pagesë e kryer nga nëna ime për këstin e radhës të apartamentit të prenotuar prej saj”.

⁹ Përgjigjet e pyetësorit të datës 9.12.2019.

Nga verifikimi i mandatit rezulton se pagesa është kryer nga shtetasit Sokol dhe L.N, me përshkrimin “prenotim apartamenti me sip. 144.8 m² te porti”.

Komisioni ka kërkuar informacion pranë shoqërisë ndërtuese “Ç” sh.p.k., si dhe dokument shkresor në lidhje me pagesat e kryera nga subjekti për pasurinë apartament në pronësi të tij.

Shoqëria “Ç” sh.p.k.¹⁰ informon se me shtetasit Sokol dhe L.N është lidhur kontrata e porosisë (ndërtim e blerje apartamenti datë 13.11.2011, me nr. *** rep., për shitjen e apartamentit me sip. 144.8 m², në çmimin 65.160 euro).

Shoqëria shpjegon se blerësit kanë paguar shumën 20.000 euro kur kanë lidhur kontratën. Shuma prej 30.000 euro është paguar nëpërmjet bankës në llogarinë bankare të shoqërisë. Pjesa tjetër është paguar në 2 këste: 7.160 euro dhe 8.000 euro sipas mandatarkëtimeve.

Blerësit kanë paguar të gjithë çmimin e apartamentit dhe kontrata e shitjes datë 23.3.2015 është lidhur te noteri.

Bashkëlidhur kontratës, shoqëria “Ç”¹¹ sh.p.k. ka sjellë dokumentet e pagesës sipas shpjegimeve, të cilat përputhen me dokumentet e depozituara nga subjekti.

1.4 Analiza financiare

Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* të subjektit dhe bashkëshortes, bazuar në deklaratimet e tij në DVP, si dhe në procesverbalet e mbajtura ndër vite pranë ILDKPKI-së.

Subjekti, në deklaratën fillestare të vitit 2003, nuk deklaroi kursime *cash* por vetëm një parapagesë në shumën 6.000 euro, paguar një shoqërie ndërtimi për prenotim apartamenti si dhe një depozitë bankare në shumën 350.000 lekë në “ProCredit Bank”.

Në DPV-në e vitit 2004 subjekti deklaroi shumën *cash* prej 18.000 euro me burim pagat e tij dhe të bashkëshortes në vite. Në procesverbalet e mbajtura pranë ILDKPKI-së, subjekti deklaroi të njëjtin burim për këto kursime. Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime për burimin e kësaj shume, si dhe përse nuk ishte deklaruar kjo shumë në DPV-në fillestare. Subjekti ka shpjeguar, në përgjigje të pyetësorit, se shuma prej 18.000 euro ka qenë e familjes së tij dhe e prindërve respektivisht në masën 50 % dhe se nuk e ka deklaruar në DPV pasi nuk e kishte të qartë mënyrën e deklarimit.

Gjithashtu, subjekti nuk e ka pretenduar gjendjen *cash* si kursim me ½ me prindërit e tij në procesverbalin në ILDKPKI, në datën 26.3.2007. Edhe në procesverbalin e firmosur në ILDKPKI, protokolluar në datën 17.11.2011 ai citon: “... nga pasuria e grumbulluar në vite nga puna ime dhe e bashkëshortes, kisha gjendje *cash* edhe rreth 18.000 euro ...”.

Komisioni analizoi mundësinë e krijimit të shumës *cash* prej 17.211 euro¹² për periudhën 1996 – 2003.

Përshkrimi	1996-2003
Pasuri	2 724 944
Likuiditete në bankë	2 724 944

¹¹ Bashkëlidhur: nxjerrje llogarie e shoqërisë “Ç” sh.p.k., e datës 27.12.2012, me detaje pagesë “kalim fondi për blerje apartamenti”, në shumën 30.000 euro; mandatarkëtimi nr. **, datë 22.2.2015, me përshkrimin: arkëtuar nga shtetasi Sokol Ngresi shuma prej 8.000 euro, për likuidim apartamenti; mandatarkëtimi nr. **, datë 18.12.2014, me përshkrimin: arkëtuar nga shtetasi Sokol Ngresi shuma prej 7.160 euro, për likuidim apartamenti; mandatarkëtimi nr. *, datë 14.11.2012, me përshkrimin: arkëtuar nga shtetasit Sokol dhe L. N shuma prej 20.000 euro, për prenotim apartamenti me sip. 144 m²;

¹² Subjekti ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 2 se gjatë vitit 2004 ka shtesë të gjendjes *cash* në shumën 100.000 lekë.

Pasuri neto	2 724 944
Të ardhura	4 570 872
Të ardhura subjekti	3 238 392
Të ardhura bashkëshortja	1 270 203
Interesa nga depozitat në banka	62 277
Shpenzime	1 574 582
Shpenzime jetese	1 375 582
Shpenzime qiraje	136 000
Shpenzime mobilimi	63 000
Rezultati financiar	271 347

✓ **Referuar tabelës, duket se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur mundësi financiare për të krijuar kursimet e deklaruara deri në vitin 2003.**

Sa i përket mundësisë së krijimit të gjendjes *cash* ndër vite, për periudhën 2004 – 2012, deri në momentin që subjekti ka paguar shumën prej 50.000 euro shoqërisë së ndërtimit, referuar tabelës së analizës financiare përmbledhëse, duket se subjekti ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për ta krijuar atë dhe për ta përdorur si burim.

Komisioni, gjithashtu, kreu analizën financiare për mundësinë e blerjes së pasurisë me burime të ligjshme për vitet 2012, 2014 dhe 2015 sipas mandatpagesave bërë shoqërisë së ndërtimit.

Përshkrimi	2012	2014	deri më 22.2.2015
Pasuri	5 523 685	1 105 109	578 756
Diferencë likuiditeti	(1 462 315)	136 575	(522 444)
Likuiditete në fund	2 021 134	2 691 294	2 168 850
Detyrime	3 435 618	(443 909)	(36 875)
Pasuri neto	2 088 068	1 549 018	615 631
Të ardhura	3 670 481	2 960 814	344 621
Shpenzime	1 446 414	1 531 015	152 628
Rezultati financiar	135 999	- 119 218	- 423 638

Referuar analizës financiare sa më sipër, rezultoi se subjekti nuk justifikon me burime të ligjshme pagesën e bërë në dhjetor të vitit 2014 dhe atë të kryer në shkurt të vitit 2015. Balanca totale negative për këto dy pagesa është në shumën - 542 856 lekë.

- ✓ Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

1.5 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e rezultateve të hetimit, depozituar në datën 3.12.2020, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare duke pretenduar që shpenzimet e jetesës për të dhe familjen e tij nuk duhet të llogariten sikurse i ka bërë Komisioni sipas standardit të ILDKPKI-së. Subjekti ka pretenduar që analiza financiare e kryer për shpenzimet e jetesës duhet të bëhet mbi bazën e anketave në vite të bëra nga INSTAT-i, specifikisht për qytetin e Vlorës. Subjekti ka pretenduar se ky standard ndryshon nga njëri qytet në tjetrin dhe, për pasojë, analiza financiare e kryer nga Komisioni duhet të marrë në konsideratë vendbanimin në qytetin e Vlorës dhe shpenzimet sipas qytetit.

1.6 Arsytimi ligjor

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë apartament në Vlorë. Për sa i përket pretendimit të subjektit, në lidhje me standardin e ndjekur nga Komisioni në përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës, qëndron si argument logjik për faktin se bazohen mbi një studim konkret të tregut dhe reflekton realitetin sipas qyteteve, si dhe referon një dokument zyrtar. Por tashmë, Komisioni ka një standard të vendosur, i unifikuar për të gjitha subjektet, në të gjithë territorin e vendit, pavarësisht vendbanimit të tyre. Në vijim të këtij argumenti, Komisioni argumenton se balanca negative e rezultuar nga analiza financiare për subjektin nuk është në atë masë sa subjekti të konsiderohet fajtor dhe, për pasojë, të passjellë aplikimin e një mase disiplinore.

Përfundimisht u konkludua se subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë apartament, ka shpjeguar bindshëm burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

2. Apartament banimi¹³ me sip. 49.76 m² në Vlorë, aktualisht kjo pasuri i ka kaluar me kontratë dhurimi nipit të subjektit datë 11.11.2017.

Burimi i krijimit: dhurim nga prindërit e subjektit, Th dhe A. N.

Pjesa në përçindje: në momentin e deklarimit subjekti zotëronte 100 % të pasurisë.

2.1 Hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se:

ASHK-ja Drejtoria Vendore Vlorë¹⁴ informon së në emër të z. Sokol Ngresit ka qenë e regjistruar pasuria apartament me sip. 49.76 m², z. k. ***, nr. ****, vol. *, f. ***. Kjo pasuri me akt dhurimi ka kaluar në favor të z. I. N, i cili është nipi i subjektit (djali i vëllait).

2.2 Analiza e fakteve

Komisioni hetoi mbi origjinën e këtij apartamenti, nga ku rezultoi se fillimisht, ky apartament është fituar në pronësi të xhaxhait të subjektit (J. N dhe bashkëshortes së tij A. N), nga procesi i privatizimit të banesave shtetërore me kontratën e privatizimit nr. ***, datë 4.5.1994, të regjistruar në hipoteke me nr. ***, datë 14.5.1995. Më pas është blerë nga babai i subjektit, Th.N me

¹³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- kontratë shitje nr. *** rep., nr. ** kol., datë 10.9.1996, me palë shitëse J dhe A.N dhe palë blerëse Th.N, për apartamentin në lagjen "I.B", Rr. "S.Z" p. ***, shk. **, ap. **, Vlorë, në vlerën 1.100.000 lekë, likuiduar në prani të notërit; vërtetim pronësie, hipoteka Vlorë, datë 18.9.1996, nëpërmjet të cilit vërtetohet së në Zyrën e Hipotekës Vlorë, në favor të shtetasit Th.N, në regjistrat e transkriptimeve të pasurive, u regjistrua pasuria e mëposhtme: në qytetin e Vlorës, lagjja "I.B" Rr. "S. Z" p. ***, shk. **, ap. nr. **, një apartament prej një dhomë, një guzhinë, korridori, aneksi, tualet dhe ballkoni nr. *** regjistri, datë 18.9.1996;
- kontratë për privatizimin e banesës datë 8.10.1993, ndërmjet NK Banesa dhe qiramarrësit J. Ngresi për apartamentin e ndërtuar në vitin 1962. U shlye shuma 2.892 lekë; vërtetim i Ministrisë së Drejtësisë, Noteria Vlorë, nëpërmjet të cilit vërtetohet se në datën 4.5.1994, para noteres A. M u paraqitën shitësi EKB dhe blerësi J. N, të cilët deklarojnë se është një kontratë shitblerjeje e redaktuar jashtë kësaj zyre dhe me vullnët të lirë e nënshkruajnë atë në zyrën e noterit; plani i vendosjes; planimetria e apartamentit;
- kontratë dhurimi me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.3.2010, me dhurues Th dhe A. N dhe pranues dhurimi z. Sokol Ngresi të një apartamenti me nr. pasurie ****, z. k. ****, vol. *, f. *** në Vlorë, me sip. 49.76 m²; Dhuruesit këtë pasuri ia dhurojnë djalit të tyre Sokol Ngresi, i cili merr përsipër shlyerjen e detyrimit ndaj Bankës Kombëtare Greke, që ka përfutur në kushtet që pala dhuruese si bashkëpronar të pasurisë më sipër janë bërë dorëzanës në favor të marrjes së kredisë nga Sokol Ngresi, i cili në këtë kontratë është me cilësinë e palës pranuese të dhurimit;
- certifikatë për vërtetim pronësie me datë lëshimi 1.3.2007, ZVRPP Vlorë, z. k. ***, nr. pasurie ****, vol. **, f. ***, lloji apartament me sip. 49.76 m² në Vlorë, në pronësi të z. Th. N; kartela e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit në emër të z. Th.N;
- certifikatë për vërtetim pronësie ****, me datë lëshimi 10.5.2010, ZVRPP Vlorë, z. k. ***, nr. pasurie ****, vol. **, f. ***, lloji apartament me sip. 49.76 m² në Vlorë, në pronësi të z. Sokol Ngresi; kartela e pasurisë dhe harta treguese për pasurinë në z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. **, f. ***, lloji apartament me sip. 49.76 m² në emër të z. Sokol Ngresi;
- vërtetim i "Raiffeisen Bank", datë 20.1.2017, për shtetasen A. N, e cila ka llogari rrjedhëse në lekë dhe në euro në këtë bankë;
- vërtetim i "Fibank", datë 26.1.2017, nëpërmjet të cilit vërtetohet së znj. A. N ka llogari në këtë bankë me balancë 674.908 lekë.

¹⁴ Me shkresën nr. **** prot., datë 23.10.2019.

kontratën e shitjes nr. *** rep., datë 10.9.1996, kundrejt çmimit 1.100.000 lekë, likuiduar tërësisht dhe transkriptuar në favor të babait të subjektit në regjistrat e transkriptimeve të Hipotekës Vlorë me nr. *** regjistri, datë 18.9.1996.

Nga aktet e administruara në dosje ka rezultuar se subjekti, në datën 9.5.1998, është emëruar në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Referuar kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.9.1996, kjo pasuri është blerë nga prindërit e subjektit, përpara se subjekti të fillontë detyrën e gjyqtarit.

Më tej, me kontratën e dhurimit me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.3.2010, shtetasit Th dhe A.N i dhurojnë djalit të tyre Sokol Ngresi, një apartament me sip. 49.76 m², me nr. pasurie *****, z. k. ***, vol. *, f. **.

Kjo banesë ishte vënë si kolateral nga prindërit e subjektit për një kredi që subjekti ka përfutur. Nga analizimi i dokumentacionit bankar evidentohet që subjekti dhe bashkëshortja të ketë shlyer kredinë në NBG, nga viti 2007 deri në vitin 2012. Në dosje rezulton gjithashtu kontrata e dhurimit me nr. *** rep., *** kol., datë 11.11.2017, e kësaj pasurie me sip. 49.76 m², sipas së cilës z. Sokol Ngresi, në cilësinë e palës dhuruese ia dhuron këtë pasuri nipit të tij I. N.

2.3 Arsyetimi ligjor

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë apartament në Vlorë të dhuruar nga prindërit në vitin 2010.

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar deklarimet e subjektit përputhen me aktet ligjore. Për faktin se kjo pasuri është blerë nga babai i subjektit në vitin 1996, përpara se subjekti të emërohej në detyrën e gjyqtarit, u konkludua se nuk mund të ngrihen dyshime për pasuri të fshehur të subjektit, si të blerë në emër të prindërve.

Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të deklaratimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ekzistencën e kësaj pasurie, mënyrën e fitimit, burimin e krijimit të saj, si dhe kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

3. Automjet tip “S.Y”¹⁵ blerë nga shoqëria “P. A” sh.p.k.

Vlera e deklaruar: 14.500 euro.

Pjesa në përqindje: 50 % në bashkëpronësi me bashkëshorten.

¹⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- kontratë shitje automjeti datë 19.2.2010, me palë shitëse “P.A” sh.p.k. dhe palë blerëse Sokol Ngresi të automjetit tip “S.Y A ** TFSI” me nr. shasie *****, kundrejt çmimit 14.500 euro. Blerësit kanë paguar vlerën e plotë 14.500 euro para marrjes në dorëzim të automjetit tip “S. Y”;
- akt dorëzimi datë 19.2.2010 i automjetit nga shoqëria “P.A” sh.p.k., te shtetasi Sokol Ngresi, nr. shasie *****, targa TR *** PR.
- mandatarëtimi nr. *, datë 19.2.2010, arkëtuar nga z. Sokol Ngresi vlera 11.000 euro, pagesë për blerje automjeti tip “S”;
- faturë tatimore shitje datë 19.2.2010, shitës “P. A” sh.p.k. dhe blerës shtetasit Sokol dhe L. N, vlera me tvsh 14.500 euro;
- vërtëtim i DRSHTRr-së Vlorë, nr. *** prot., datë 24.10.2016, nëpërmjet të cilit vërtetohet se shtetasi Sokol Ngresi nuk është pronar i automjetit tip “M. B” me nr. shasie *****, me targa VL ***** C. Ky automjet ka kaluar në pronësi të shtetasit H. V. Bashkëlidhur kontrata e shitjes së automjetit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.12.2009, me palë shitëse Sokol Ngresi dhe palë blerëse H.V, marka gjermane, tip “M – B E ****”, me nr. shasie *****, targa VL **** C, në vlerën 7.000 euro, likuiduar jashtë zyrës së noterit;
- zhdoganimi i automjetit me vend origjine Gjermani, nr. shasie *****. Vlera e automjetit 2.000 euro, vlera e zhdoganimit 198.293 lekë;

Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga e subjektit si gjyqtar dhe si avokat dhe të ardhurat nga paga e bashkëshortes, si dhe vlera e përfituar nga shitja e automjetit në pronësinë e tij tip “M-B” me targa VL *** C në vlerën 7.000 euro (kontratë shitje nr. **** rep., datë 11.12.2009). Subjekti ka sqaruar se ky automjet (M-B) është blerë prej tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe çmimi i plotë është paguar nga shtetasit K dhe A. S, kushërinjtë e tij të parë që jetojnë dhe punojnë në Itali, ndërkohë që prej subjektit është paguar vetëm vlera e zhdoganimit të këtij automjeti në shumën 198.293 lekë.

Deklarimi në DPV: në DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti, por e ka deklaruar blerjen e saj në DPV-në e vitit 2009, dorëzuar më 19.3.2010.

Mënyra e fitimit: me kontratën e shitjes datë 19.2.2010, noteri E. I.

3.1 Hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se:

DPSHTRr-ja¹⁶ ka konfirmuar se shtetasi Sokol Ngresi ka në bashkëpronësi me shtetasen L. N automjetin me targa AA ****AB.

DPSHTRr-ja ka bashkëlidhur dokumentet e fitimit të pronësisë së shtetasve Sokol dhe L.N për automjetin me targa AA *** AB, ku ndër të tjera u administrua edhe fatura tatimore e shitjes datë 19.2.2010, me shitës “P. A” sh.p.k. dhe blerës shtetasit Sokol dhe L. N, ku vlera e automjetit përfshi tvsh-në është 14.500 euro.

Referuar kontratës së shitblerjes, blerësit kanë paguar vlerën e plotë 14.500 euro, para marrjes në dorëzim të automjetit tip “S. Y”.

3.2 Analiza financiare

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se subjekti ka kryer pagesat në dy këste, sipas faturave tatimore përkatëse: e para në shumën 3.500 euro në dhjetor të vitit 2009 dhe e dyta në shumën 11.000 euro në shkurt të vitit 2010.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për të kryer dy pagesat për automjetin në vitet 2009 dhe 2010.

3.3 Arsyetimi ligjor

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje dhe analizimit të burimeve të ligjshme, ka konstatuar se subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë automjet dhe ka rezultuar se ka burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

4. Automjet tip “F. P”¹⁷ blerë nga shoqëria “A” sh.p.k., me kontratën e shitjes datë 30.9.2008.

¹⁶ Me shkresën nr. **** prot., datë 8.10.2019.

¹⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- kontratë shitblerje nr. ***, datë 30.9.2008, me palë shitëse “A” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasit L dhe Sokol Ngresi, për automjetin tip “F.P” me nr. shasia TA *****, në vlerën 8.800 euro. Ekzekutimi i detyrimit prej palëve bëhet në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate. Pagesa prej 10.000 euro do lëvrohet: 5.000 euro pagesë e menjëhershme dhe pjesa e mbetur prej 5.000 euro do të ekzekutohet deri në datën 11.9.2008;
- dokument në emër të shtetasve L dhe Sokol Ngresi, Vlorë, kufijeron automjet tip “F. P”, shasia nr. *****, dorëzimi datë 30.9.2008, importues shoqëria “A” sh.p.k.;

Vlera e deklaruar: 8.800 euro.

Pjesa në përqindje: 50 % në bashkëpronësi me bashkëshorten.

Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga si gjyqtar dhe si avokat, si dhe të ardhurat nga paga e bashkëshortes; vlera e përfituar nga shitja e automjetit në pronësinë e subjektit tip “M. B” me targa VL ****, në vlerën 500.000 lekë (kontratë shitje nr. ****, rep., datë 21.6.2008).

Deklarimi në DPV: në vitin 2008 subjekti është shkëputur nga detyra. Për herë të parë ky automjet është deklaruar në DPV para fillimit të detyrës në vitin 2009. Deklaruar si automjet blerë në shumën 8.800 euro.

Mënyra e fitimit: me kontratën e shitjes të datë 30.9.2008.

4.1 Hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se:

DPSHTRr-ja¹⁸ konfirmon së shtetasit Sokol dhe L. N kanë në bashkëpronësi automjetin me targa AA **** HL, të regjistruar në DRSHTRr-në Vlorë.

DPSHTRr-ja ka bashkëlidhur dokumentet e fitimit të pronësisë së shtetasve Sokol dhe L.N për automjetin me targa AA *** HL. Faturë tatimore shitje datë 30.9.2008, shitës shoqëria “A” sh.p.k., dhe blerës shtetasit L dhe Sokol Ngresi. Vlera: 8.800 euro.

Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 30.9.2008 rezulton se “A” sh.p.k. i shet blerësve L dhe Sokol Ngresi, automjetin tip “F. P” në vlerën 8.800 euro. Pagesa prej 10.000 euro do të lëvrohet: 5.000 euro pagesë e menjëhershme dhe pjesa e mbetur prej 5.000 euro do të ekzekutohet deri në datën 11.9.2008.

4.2 Analiza financiare

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit, me kursimet nga të ardhurat nga paga shumën prej 8.800 euro.

Referuar analizës, subjekti ka pasur mjaftueshëm kursime *cash* për të paguar shumën e reflektuar edhe në uljen e kursimeve *cash* në analizën financiare.

4.3 Arsyetimi ligjor

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje dhe analizimit të burimeve të ligjshme, ka konstatuar se subjekti në deklaratën vetting ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë automjet dhe ka burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me pikën 5/a, të nenin 33 të ligjit 84/2016 dhe pika 3 e nenit D të aneksit të Kushtetutës.

5. Armë zjarri¹⁹ tip Pistoletë, blerë më 9.7.2016

Vlera e deklaruar: 82.200 lekë.

– vërtetim nr. **** prot., datë 24.10.2016, i DRSHTRr-së Vlorë, nëpërmjet të cilit vërtetohet së shtetasi Sokol Ngresi nuk është pronar i automjetit tip “M- B” me nr. shasie *****, me targa VL **** C. Ky automjet ka kaluar në pronësi të shtetasit F. K. Bashkëlidhur kontrata e shitjes së automjetit tip “B- A **”, me nr. **** rep., nr. **** kol., datë 21.6.2008, me palë shitëse Sokol Ngresi dhe palë blerëse F. K; nr. shasie *****, targa VL **** C, në vlerën 500.000 lekë (Aneks 4/4).

¹⁸ Me shkresën nr. ***** prot., datë 8.10.2019.

¹⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

– autorizim nr. **, datë 22.7.2016, për blerje armë zjarri në vendbanim, nëpërmjet të cilit autorizohet shtetasi Sokol Ngresi për të blerë armë të kategorisë “B” për në vendbanim, pranë subjekteve të licensuara nga Drejtoria e Policisë së Shtetit si vijon: I (një) armë të shkurtër të kalibrit 7.62 mm deri 9 mm të katëgorisë “BI”.

– faturë tatimore shitje datë 9.7.2016 me shitës “R.G” S dhe blerës z. Sokol Ngresi, të një arme zjarri në vlerën 82.200 lekë;

– autorizim i posaçëm në emër të z. Sokol Ngresi, lëshuar datë 1.8.2016 nga Drejtoria e Policisë së Shtetit për mbajtje armë zjarri në banesë;

Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga e subjektit.

- ✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.
- ✓ Subjekti kishte burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

6. Llogari kursimi²⁰ në emër të fëmijëve

- J. N, gjendja 1.597.280 lekë dhe 432 euro, në datën 24.10.2016;
- K. N, gjendja 955.677 lekë dhe 53 euro, në datën 20.1.2017.

Burimi i krijimit për të dyja llogaritë janë pagat e subjektit dhe bashkëshortes, pagesa periodike automatike mujore.

6.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

“Raiffeisen Bank”²¹ ka konfirmuar gjendjet e likuiditeteve në këto llogari:

- J. N llogari kursimi në euro me balancë në datën 27.1.2017, vlerën 432 euro; llogari kursimi në lekë, me balancë në datën 27.1.2017, vlerën 1.617.282 lekë;
 - K. N ka llogari kursimi në lekë me balancë në datën 27.1.2017, vlerën 975.677 lekë, llogari kursimi në euro me balancë në datën 27.1.2017, vlerën 53 euro.
- ✓ Nga verifikimi i dokumentacionit bankar ka rezultuar se këto likuiditete janë krijuar me burim të ardhurat nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes.

7. Fond investimi²² në Raiffeisen Invest

Vlera e deklaruar: 259.779 lekë.

Pjesa në përqindje: 50 % në bashkëpronësi me bashkëshortën.

Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortes në vite.

7.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

Raiffeisen Invest²³ konfirmon se shtetasja L.N ka investuar në fondin Raiffeisen Prestigj. Gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017 është 270.405 lekë.

- ✓ Nga hetimi i kryer duket se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga Raiffeisen Invest.

8. Kursime *cash* jashtë sistemit bankar

Vlera e deklaruar: 380.000 lekë dhe 2.500 euro.

Pjesa në përqindje: 50 % në bashkëpronësi me bashkëshorten.

Burimi i krijimit: të ardhurat në vite nga paga e subjektit dhe bashkëshortes.

8.1 Analiza financiare

²⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

vërtetim nga “Raiffeisen Bank”, datë 20.1.2017, nëpërmjet të cilit vërtetohet se:

- J. N ka llogari rrjedhëse dhe depozitë pa afat në lekë dhe euro, me gjendje shumat 1.597.280 lekë dhe 432 euro;
- K. N llogari kursimi në lekë me balancë në datën 27.1.2017, vlerën 975.677 lekë; llogari kursimi në euro me balancë në datën 27.1.2017, vlerën 53 euro;

²¹ Me shkresën nr. **** prot., datë 10.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

²² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- vërtetim nga Raiffeisen Invest, datë 24.1.2017, mbi pasqyrën e llogarisë në emër të znj. L.N për periudhën 22.6.2015 – 30.3.2016. Vlera totale e kuotave 259.779 lekë.

²³ Me shkresën nr. **** prot., datë 3.10.2019.

Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* kursime *cash* në banesë në fund të vitit 2016, me burim kursimet e familjes ndër vite, në shumat 380.000 lekë dhe 2.500 euro, e konvertuar në lekë në shumën totale prej 718.175 lekë.

Përshkrimi	2016
Pasuri	1 002 245
Detyrime	(445 596)
Pasuri <i>neto</i>	1 447 840
Të ardhura	3 141 717
Shpenzime	2 224 203
Rezultati financiar	- 530 326

Pas verifikimit të deklarimeve në vite për gjendjen *cash*, nga analiza e kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të pasur kursime *cash*, të deklaruara në deklaratën *Vetting* në shumën -530.326 lekë.

✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Kushtetutës.

8.2 Qëndrimi i subjektit

Në lidhje me gjendjen negative që ka rezultuar në analizën financiare të kryer për vitin 2016, në prapësimet e depozituara në datën 3.12.2020, subjekti ka pretenduar se në gjendjen *cash*, të deklaruar prej tij për këtë vit, është përfshirë edhe shuma e vjedhur nga ish-pastruesja e banesës, për të cilën ka pasur edhe një proces gjyqësor. Subjekti ka pretenduar se gjendja *cash* e konsideruar nga Komisioni në analizën financiare duhet të pakësohet duke i zbritur shumën 435,270 lekë.

Gjithashtu, subjekti ka pretenduar që Komisioni, në analizën financiare, të llogarisë shpenzimet e jetesës sipas standardit të INSTAT-it për qarkun e Vlorës.

8.3 Analiza ligjore

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje, duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit në prapësime, si dhe dokumentacionin justifikues ligjor të depozituar prej tij, ka marrë në konsideratë pretendimin e subjektit duke reflektuar në analizën financiare zbritjen nga gjendja *cash* e deklaruar në shumën 435.270 lekë.

Ndonëse është konstatuar një pasaktësi në deklaratën *Vetting*, për sa kohë subjekti ka përfshirë në masën monetare të deklaruar si gjendje *cash* në banesë edhe shumën që i ishte vjedhur dhe që, për rrjedhojë, ai nuk e dispononte realisht, trupi gjykues, nisur nga fakti që ai ka shpjeguar se e konsideronte këtë shumë si një të ardhur të kursyer prej tij dhe që mendonte se do t'i rikthehej në disponibilitet, pasi kishte një gjykim mbi këtë rrethanë, e konsideron të pamjaftueshme këtë pasaktësi për të passjellë pasoja për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Ngresi.

Referuar analizës financiare përmbledhëse pas prapësimeve, për vitin 2016, subjekti ka rezultuar me një balancë negative në shumën -169.053 lekë.

9. Kredi e marrë nga “Raiffeisen Bank”²⁴ në datën 27.12.2012, në shumën 30.000 euro, me afat 109 muaj, me interes 1.54 % në vit (kësti mujor 296 euro). Shuma e detyrimit financiar 17.191.56 euro.

²⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

– vërtetim datë 27.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, nëpërmjet të cilit vërtëtohet se znj. L. N është kliente e kësaj banke me kredi në euro, në shumën 30.000 euro, hapur datë 27.12.2012; gjendja e mbetur në datën 24.1.2017 është në shumën 17.191 euro;

“Raiffeisen Bank”²⁵ ka konfirmuar se znj. L. N është kredimarrëse në datën 27.12.2012, në shumën 30.000 euro. Detyrimi i mbetur i kredisë në shumën 7.987 euro.

- ✓ Nga verifikimi i të dhënave bankare deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

10. Llogari page²⁶ në shumën 21.665 lekë, datë 27.1.2017, në “Raiffeisen Bank”

“Raiffeisen Bank”²⁷ ka konfirmuar në emër të z. Sokol Ngresi, llogarinë rrjedhëse të pagës.

11. Gjendja e llogarisë²⁸ së kartës së kreditit në euro, në “Raiffeisen Bank”, në datën 27.1.2017, me shumë 1.300 euro.

“Raiffeisen Bank”²⁹ ka konfirmuar në emër të z. Sokol Ngresi kartë krediti në euro, me balancë në datën 27.1.2017, vlerën -223.25 euro dhe limit 177.541 lekë.

ALUIZNI³⁰ ka konfirmuar se subjekti Sokol Ngresi dhe personat e lidhur me të nuk figurojnë si subjekte aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal, në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve.

ASHK-të drejtoritë vendore nuk kanë konfirmuar ndonjë aplikim/praktikë për legalizim.

12. Pasuri në përdorim të deklaruara nga subjekti

Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka shpjeguar se: *“Adresa ku kam jetuar në shtatë vitet e fundit është po ajo e shënuar në vetëdeklarim, në formularët e shtatë viteve të fundit”*.

Nga hetimi i kryer në lidhje me banesat në përdorim të deklaruara nga subjekti nuk u ngritën dyshime dhe shumat e paguara si qira për banim janë përfshirë në analizën financiare (për më shumë lexoni rezultatet e hetimit).

13. Pasuri e përfitur nga subjekti në janar të vitit 2019

Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se në janar të vitit 2019, subjektit i ka kaluar në pronësi një apartament në Vlorë, pasi nëna e subjektit ka ndërruar jetë. Kjo pasuri është blerë në vitin 2015 nga shoqëria “Ç” sh.p.k., në shumën 46.800 euro, e regjistruar në ZVRPP Vlorë, pasuria me nr. ****-n*, vol. **, f.***, z. k. ****.

Sipas kontratës së blerjes referohet se palët deklarojnë se e gjithë shuma në fjalë është likuiduar jashtë zyrës noteriale me këste sipas dokumenteve bashkëlidhur.

13.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

– vërtetim datë 26.1.2017 nga “Raiffeisen Bank”, nëpërmjet të cilit vërtetohet së znj. L. N ka detyrim kredie në vlerën 17.202 euro në datën 26.1.2017;

– vërtetim datë 20.1.2017 nga “Raiffeisen Bank”, mbi produktet bankare të znj. L. N. Në datën 27.12.2012 figuron disbursimi i kredisë në vlerën 30.000 euro. Balanca në fund të vitit 2016 ka qenë në vlerën 17.191 euro.

²⁵ Me shkresën nr. **** prot., datë 8.10.2019.

²⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

– vërtetim nr. **** prot., datë 27.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, nëpërmjet të cilit vërtetohet së z. Sokol Ngresi ka në këtë bankë llogari rrjedhëse në lekë, hapur datë 28.2.2005; gjendja e disponueshme e llogarisë në datën 27.1.2017 është në vlerën 21.665 lekë.

²⁷ Me shkresën nr. **** prot., datë 8.10.2019.

²⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (Aneks nr. 4/12).

– vërtetim nr. *** prot., datë 27.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, nëpërmjet të cilit vërtetohet së z. Sokol Ngresi ka në këtë bankë kartë në euro, në shumën 1.300 euro, hapur datë 10.3.2010; gjendja e disponueshme e llogarisë në datën 27.1.2017 është 1.076 euro.

²⁹ Me shkresën nr. **** prot., datë 8.10.2019.

³⁰ Me shkresën nr. **** prot., datë 9.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

Komisioni ka kërkuar pranë ASHK-së informacion për pasuri të paluajtshme dhe në emër të prindërve të subjektit. ASHK Drejtoria Vendore Vlorë³¹ nuk konfirmon pasuri në pronësi të prindërve të subjektit.

ASHK – Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2019³², ka informuar së subjekti ka në pronësi në Vlorë pasurinë nr. *****-n**, vol. ***, f. ****, z. k. ****, të fituar nëpërmjet kontratës së dhurimit “me kusht bashkë – uzufrukti me afat jetësor” datë 20.10.2018.

Subjekti, në lidhje me këtë pasuri, ka shpjeguar se: “... pasi nëna ndërroi jetë datë 5.2.2019 apartamenti ka kaluar në pronësinë time...”.

Komisioni, në përputhje me pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 i ka kërkuar subjektit dokumentacion justifikues mbi burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie, duke e konsideruar si pasuri të subjektit të fituar nëpërmjet dhurimit.

13.2 Analiza financiare

Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, ku provohen të ardhurat e ligjshme të prindërve, Komisioni kreu një analizë financiare duke përllogaritur mundësinë e krijimit të kursimeve për periudhën 1996 – 23.3.2015 nga prindërit e subjektit, reflektuar në tabelën si vijon:

Përshkrimi	1996 – 23.3.2015
Të ardhura totale	9 425 735
Të ardhura nga paga dhe pensione	6 025 735
Fondi i dhuruar nga nusja e djalit në vitin 2004	1 500 000
Të ardhurat nga shitja e apartamentit në gusht të vitit 2005	1 900 000
Shpenzime jetese	3 748 583
Likuiditete më 23.3.2015	426 015
Apartament blerë në vitin 2015	6 439 680
Rezultati financiar	- 1 188 543

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme nga prindërit e subjektit në shumën 1.188.543 lekë.

✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe Nenit D të Kushtetutës.

13.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në prapësime, ka depozituar informacion për të ardhurat në vite të përfituara nga prindërit, si dhe informacion shtesë në lidhje me punësimin e nënës në shkolla private për periudhën 2005 – 2015 si vijon:

- vërtetim zyrtar me nr. ****prot., datë 19.11.2020, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për z. Th.N, për periudhën janar 1996 – 30.4.2010, rezulton se ka përfiturar të ardhura *neto* nga pensioni i pleqërisë dhe pensioni suplementar në shumën prej 2.177.625 lekësh;
- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për znj. A.N, e cila për periudhën janar 1996 – shtator

³¹ Me shkresë nr. **** prot., datë 23.10.2019.

³² Me shkresë nr. **** prot., datë 23.10.2019.

2005 rezulton se të ardhurat *neto* të përfituara si e punësuar në Departamentin e Arsimit Vlorë janë në shumën prej 1.521.222 lekësh;

- vërtetim zyrtar me nr. ****prot, datë 19.11.2020, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për znj. A.N, e cila për periudhën shtator 2005 – 23.3.2015 rezulton se ka përfiturar të ardhura *neto* nga pensioni i pleqërisë në shumën prej 2.253.788 lekësh;
- vërtetim zyrtar të lëshuar nga shkolla jopublike “I” për znj. A.N, e cila për periudhën 2006 – 2008 është punësuar me pagë *bruto* në shumën 35.000 lekë dhe për periudhën 2008 – 2009 është punësuar me pagë *bruto* në shumën prej 17.500 lekësh;
- vërtetim zyrtar të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë për znj. A.N, e cila për periudhën tetor 2013 - maj 2014 është punësuar pranë shkollës jopublike “H” me pagë *bruto* në shumën prej 22.000 lekë/muaj.

Subjekti ka depozituar edhe fakte të tjera dhe dokumentacion në lidhje me të ardhura të krijuara nga babai i tij si përkthyes ndër vite, por që nuk provohen të jenë paguar tatime dhe në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës nuk janë përfshirë në analizën financiare pas prapësimeve.

Subjekti, në prapësime, ka pretenduar gjithashtu edhe konvertimin e shumave sipas viteve kur janë krijuar të ardhurat në euro dhe jo me kursin e vitit 2015 siç e ka llogaritur Komisioni.

13.4 Analiza ligjore

Pas prapësime të subjektit dhe analizimit të dokumentacionit të depozituar prej tij, njësia e shërbimit ligjor të Komisionit kreu analizën financiare, duke reflektuar në analizë të gjithë dokumentacionin ku provoheshin të ardhurat e ligjshme të nënës, të përfituara nga punësimi si mësuese në institucione arsimore, sipas parashikimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të përshkruara.

Në lidhje me pretendimin e subjektit për konvertimin e shumave në euro sipas viteve, trupi gjykues e ka pranuar pjesërisht këtë pretendim. Nga verifikimi i llogarive bankare në vitin 2005, ka rezultuar se z. Th. N ka depozituar në llogarinë e tij bankare një shumë rreth 24.000 euro, pra *indicie* që kursimet mund të jenë kthyer në euro ndër vite.

Në përfundim, shumat prej 1.500.000 lekësh (nga dhurata e bashkëshortes) dhe 1.900.000 lekë (nga shitja e apartamentit) janë konvertuar me kursin e këmbimit mesatar të vitit 2005 (1 eur = 122,4 lekë) në shumën 27.746 euro.

Nga shuma totale e blerjes së apartamentit prej 46.800 euro, diferenca është konvertuar me kursin mesatar të viteve 2012 – 2015, vite në të cilat janë kryer pagesat për blerjen e pasurisë.

Përfundimisht ka rezultuar se prindërit e subjektit me të ardhurat e tyre për periudhën 1996 – 23.3.2015, kishin mundësi për të blerë këtë pasuri me burime të ligjshme, në përputhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit vërehet se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë dhe nuk janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë prej tij. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, deklaramet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Trupi gjykues arsyeton se balancat negative të rezultuara nga analiza financiare e pasurive dhe e shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit, bazuar në analizën e përditësuar financiare (shihni tabelën sa më poshtë), nuk është i një shkalle të tillë që të cenojë besimin e publikut. Vetë natyra e analizës

financiare mund të paraqesë një shkallë të caktuar pasaktësie në elementët që vlerëson. Ajo thjesht, shërben si një tregues i të ardhurave të ligjshme, pasurive dhe shpenzimeve të jetesës për një periudhë kohe. Çdo analizë financiare, nga natyra e saj, është e përafërt dhe jo absolute.

Trupi gjykues konsideron se çdo mospërputhje në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës së subjektit të rivlerësimit janë pasqyrim i analizës financiare të Komisionit. Si të tilla, mospërputhjet nuk arrijnë nivelin e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë dhe as nuk ngrenë dyshime mbi mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se mungesa e këtij likuiditeti nuk përbën arsye për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra.

Analiza financiare përmbledhëse për periudhën 1996 – 2016

Vitet	Pasuri	Diferencë likuiditeti	Likuiditete në fund të vitit	Detyrime	Pasuri neto	Të ardhura	Shpenzime	Rezultati financiar
1996-2003	2 724 944	2 724 944	2 724 944	-	2 724 944	4 570 872	1 574 582	271 347
2004	671 640	171 640	2 896 584	-	671 640	1 325 051	371 892	281 519
2005	502 832	502 832	3 399 416	-	502 832	2 218 257	647 436	1 067 989
2006	1 006 504	308 211	3 707 627	-	1 006 504	2 027 857	1 006 640	14 713
2007	1 715 312	1 715 312	5 422 940	1 888 338	- 173 026	1 965 707	1 250 562	888 171
2008	378 779	- 710 661	4 712 279	- 290 996	669 775	2 984 920	1 060 434	1 254 711
2009	341 089	- 139 006	4 573 273	- 340 773	681 862	3 042 045	1 525 024	835 159
2010	140 581	- 1 382 259	3 191 014	- 362 656	503 238	2 124 501	1 527 242	94 021
2011	292 435	292 435	3 483 449	- 379 984	672 419	2 963 283	1 538 635	752 230
2012	5 523 685	- 1 462 315	2 021 134	3 435 618	2 088 068	3 670 481	1 446 414	135 999
2013	533 585	533 585	2 554 719	- 436 240	969 824	3 258 054	1 323 541	964 689
2014	1 105 109	136 575	2 691 294	- 443 909	1 549 018	2 960 814	1 531 015	101 602
2015	1 083 330	- 17 870	2 673 424	- 445 256	1 528 586	3 150 762	1 905 593	- 690
2016	499 937	417 737	3 091 161	- 445 596	945 532	3 141 717	2 224 203	- 169 053

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës, për subjektin e rivlerësimit, ku fillimisht:

- ✓ **DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit z. Sokol Ngresi, në detyrën e gjyqtarit.**

DSIK-ja referon se në vijim të konstatimit fillestar, për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Th. Ngresi, për rastin në fjalë, referuar një informacioni shtesë, konkluzioni për kontrollin e figurës të mbetet në vlerësimin e Komisionit, nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ të thelluar që kryen Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Komisioni ka verifikuar rastet e iniciuara nga DSIK-ja, duke administruar të gjitha dosjet për çështjet përkatëse dhe pasi u vlerësuan në gjithë dinamikën e tyre, nuk u konstatua ndonjë shkelje

ligjore e kryer nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nuk ka evidentuar ndonjë veprim të subjektit që mund të cenonte figurën apo aftësitë e tij profesionale.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirje e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

- ✓ **Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.**

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga KLGj-ja³³ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij); dhe
- denoncimeve të paraqitura nga publiku, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit është bërë nga KLGj-ja, i cili ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në:

- formularin e vetëdeklarimit;
 - të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të dhenat nga burimet arkivore; si dhe
 - pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.
- ✓ Në lidhje me formularin e vetëdeklarimit, nga verifikimi i kryer ka rezultuar se subjekti ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi këtë formular.

Vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit është kryer duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit, si:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

1. Aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, ka aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në aktet e shqyrtuara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, subjekti analizon në çdo rast: kualifikimin ligjor të bërë nga shkalla e parë e gjykimit, për veprën penale të konsumuar nga i pandehuri, citon dhe analizon përmbajtjen e provave të marra në shqyrtim nga gjykata duke përcaktuar fuqinë provuese të tyre; verifikon kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga legjislacioni procedural penal. Në çdo rast, subjekti analizon nga pikëpamja ligjore pretendimet e parashtruara në ankim nga palët ndaj vendimit të shkallës së parë të gjykimit,

³³ Sipas shkresës me nr. *****, prot., datë 27.12.2019.

dhe jep përgjigje të argumentuar si në rastin kur e pranon ankimin, ashtu edhe kur e vlerëson atë të pabazuar ligjrisht. Subjekti i rivlerësimit identifikon rastet kur vendimi i shkallës së parë është i gabuar dhe jep arsyet, kur është rasti, në funksion të zbatimit të ligjit ai përdor referenca nga Jurisprudenca Unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Aktet e shqyrtuara konfirmojnë njohuritë e tij në të drejtën civile, të detyrimeve penale e procedurale penale. Konstatohet se për tre dokumentet ligjore (tre vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari), është ushtruar rekurs dhe Gjykata e Lartë i ka lënë në fuqi të tre vendimet e ankimuara. Ndërkohë, nga pesë dosjet e vëzhguara, rezultoi se nuk është ushtruar rekurs nga palët në Gjykatën e Lartë.

1.1 Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të arsyetimit ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare, të arsyetuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje të argumentuar pretendimeve të ngritura nga palët në ankim. Gjyqtari i kushton vëmendje, në çdo rast, mënyrës së zgjidhjes së çështjes nga gjykata më e ulët, respektimit të dispozitave procedurale nga ana e kësaj të fundit, argumenton kur zgjidhja e dhënë prej saj është e saktë dhe kur është e gabuar dhe jep përgjigje për pretendimet e parashtruara në ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në arsyetimin e vendimit nuk mungojnë kur është rasti dhe referimi në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, por edhe çmimit dhe fuqisë provuese të provave. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Vlorë. Nga analiza e të dhënave rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve nga subjekti është 98.2 %.

Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore, gjyqtari i Gjykatës së Apelit është subjekt ndaj të cilit zbatohet vendimi nr. 261/2, datë 14.4.2010 “Sistemi vlerësimit të gjyqtarëve, Aneksi 1, për kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” i ish-KLD-së.

Nga analizimi i afateve kohore, në dosjet e vëzhguara, gjykimi është realizuar brenda afatit kohor të përcaktuar nga ligji i posaçëm apo sipas vendimit të ish-KLD-së.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Sokol Ngresi, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimet e dosjeve të shortuara dhe akteve të depozituar, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, është eficient dhe efektiv. Ai e respekton kohën në gjykim si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Në efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së tij ka ndikuar edhe ngarkesa sasiore. Përgjithësisht mund të themi se gjyqtari i ka kushtuar rëndësi edhe kohës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Nga raporti i hartuar nga KLGj-ja rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, ka aftësi të mira për të kryer procedurat gjyqësore dhe brenda afateve ligjore. Në asnjë rast nuk rezultoi që relatori Sokol Ngresi të jetë bërë shkak për dështimin e seancave.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar aftësia e gjyqtarit për të administruar aktet që përmban dosja gjyqësore dhe për t'i vendosur ato në mënyrë që të shfrytëzohen me lehtësi. Në të pesë dosjet e vëzhguara, procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal dhe janë inventarizuar aktet procedurale.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga analizimi i akteve të depozituara nga subjekti dhe dosjeve gjyqësore rezultoi se subjekti ka pasqyruar etikë të mirë në punë. Në lidhje me ankesat e depozituara për subjektin Sokol Ngresi nuk rezultoi asnjë ankesë që të lidhej me etikën në punë.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga aktet e vëzhguara nga KLGj-ja nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Sokol Ngresi. Në dosjet gjyqësore të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtim të subjektit nga gjykimi i çështjeve dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Gjithashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, nuk ka respektuar rregullat procedurale.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Me të dhënat e disponuara nga KLGj-ja, ka rezultuar se komunikimi i gjyqtarit Sokol Ngresi me palët pjesëmarrëse në proces ka qenë korrekt dhe në respektim të normave etike. Gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

Për periudhën e rivlerësimit, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore pranë KLGj-së, për gjyqtarin Sokol Ngresi nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

Komisioni, nga analizimi i tri dosjeve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe i pesë dosjeve të shortuara, sikurse është shprehur edhe KLGj-ja në raportin e tij, nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional.

- ✓ Komisioni, pas rivlerësimit të raportit të Grupit të Punës, nuk gjeti *indicie* apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale.

DENONCIMET

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka shqyrtuar 26 denoncime të depozituara nga publiku, ndaj gjyqtarit Sokol Ngresi. Subjektit iu kërkuan shpjegime për katër denoncimet vijuese:

1. Denoncim me nr. *** prot., datë 25.7.2018, i depozituar nga z. E. V

Denoncuesi është përfaqësuesi ligjor i një shtetase të mitur, e cila është nën kujdestarinë e babait të saj. Shtetasja e mitur, bashkë me familjen e saj, ishte përfshirë në një aksident rrugor me pasoja fatale për nënën e saj. Fëmija i mitur ka kërkuar dëmshpërblim nga një shoqëri sigurimi për të cilën, nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor, i është drejtuar gjykatës. Pasi çështja ka shkuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, kjo e fundit ka vendosur “kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për shkelje të rënda procedurale për shkak se e mitura nuk kishte nënshkruar padinë”. Denoncuesi, avokati i fëmijës së mitur, ka pretenduar se referuar legjislacionit shqiptar në fuqi, një person i mitur nuk ka të drejtë të nënshkruajë akte ligjore, pasi nuk ka zotësi juridike për të vepruar dhe çdo veprim i saj ligjor është kryer nga avokati, i cili është autorizuar nga kujdestari ligjor i fëmijës së mitur, nga babai i saj. Denoncuesi ka theksuar se kjo çështje është shqyrtuar edhe në Gjykatën Kushtetuese, ku një nga çështjet e para që ka zgjidhur kjo gjykatë është legjitimiteti i palëve në proces.

Subjektit iu kërkua të jepte shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti, në prapësimet e depozituara, ka shpjeguar se: “Gjykata e Apelit Vlorë ka konstatuar se paditësja M.M është e datëlindjes 10.5.2001 (fakt, i cili del i provuar nga certifikata e saj e lindjes, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Qender Fier, datë 5.3.2014). Në këtë gjykim, ajo është përfaqësuar nga 2 avokatë, kjo sipas prokurës së posaçme nr. *** rep., nr. **** kol., datë 28.10.2014. Ky akt përfaqësimi ishte lëshuar nga paditësja, nën kujdestarinë e babait të saj J. M dhe është nënshkruar prej tij. Në kohën e lëshimit të prokurës, paditësja ka qenë nën moshën 14 vjeç.

Gjykata e Apelit ka arsyetuar se kjo prokurë, e lëshuar nga paditësja, ndërkohë që i mungonte tërësisht zotësia për të vepruar, është veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, bazuar në nenin 92 germa ‘c’ të Kodit Civil. I ati i saj nuk mund ta nënshkruante këtë prokurë, pasi ka pasur konflikt interesi mes tij si kujdestar (prindi i të miturës) dhe të përfaqësuarës (vajzës së tij nën 14 vjeç), bazuar kjo në rrethanat e ngjarjes ku shkaktar i drejtpërdrejtë i dëmit pasuror dhe jopasuror të kërkuar nga paditësja ka qenë pikërisht përfaqësuesi i saj.

Gjithashtu, Gjykata e Apelit ka konstatuar se padia është ngritur në datën 8.10.2015, kohë kur paditësja M. M kishte mbushur moshën 14 vjeç. Padia është nënshkruar nga avokati, ndërkohë që Gjykata e Apelit ka vlerësuar se ky akt procedural duhej të nënshkruhej nga paditësja, si dhe një kujdestar i caktuar për të, i cili duhet të jepte pëlqimin, bazuar në germën ‘a’, të nenit 94, të Kodit Civil. Pra, në këto kushte, kemi të bëjmë me një pavlefshmëri absolute të ngritjes së padisë.

Kemi vlerësuar se me mbushjen e moshës 14 vjeç, i mituri fiton zotësi të pjesshme për të vepruar dhe sipas nenit 7 të Kodit Civil, ky subjekt mund të kryejë veprime juridike, vetëm me pëlqimin e mëparshëm të përfaqësuesit të tij ligjor. Pra, edhe kërkesëpafia, si një veprim juridik mund të paraqitet prej saj, pra me nënshkrimin e saj, por me pëlqimin e mëparshëm të përfaqësuesit të saj ligjor.

Po kështu, veç këtij elementi që lidhet me pavlefshmërinë e aktit kryesor procedural të këtij gjykimi, Gjykata e Apelit ka konstatuar edhe mosrespektimin e dispozitave procedurale që lidhen me formimin e drejtë të ndërgjyqësisë, pasi ka çmuar se në këtë gjykim duhej të merrte pjesë si person i tretë edhe subjekti që ka shkaktuar pasojën – dëmin pasuror dhe jopasuror të pësuar te paditësja, shtetasi Jetnor Muçaj, pasi, në eventualitet të pranimit të padisë, shoqërisë së sigurimit i lind e drejta e padisë së regresit ndaj shkaktarit të dëmit.”

Komisioni, në lidhje me pretendimet e ngritura nga denoncuesi, vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse dhe të pranueshme.

2. Denoncim me nr. ** prot., datë 9.3.2020, i depozituar nga znj. Zh. K**

Denoncuesja ka qenë në një konflikt pronësie me familjarët e bashkëshortit, për të cilin është zhvilluar një proces administrativ dhe më pas një proces penal. Denoncuesja pretendon se gjykatat me vendimmarrjet e tyre kanë shkelur ligjin material dhe procedural.

Denoncuesja ka depozituar kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprime abuzive dhe në shpërdorim të detyrës ndaj një juristi të ZVRPP-së Vlorë. Denoncuesja ka pretenduar se Gjykata e Apelit Vlorë dhe vendimmarrja e kësaj gjykate nuk ishte në përputhje me ligjin. Në datën 30.1.2020, Gjykata e Apelit ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e shkallës së parë dhe pas 2 muajsh nga data e shpalljes së këtij vendimi, nuk ishte bërë zbardhja e tij.

Subjektit iu kërkua të jepte shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti, në prapësimet e depozituara, ka shpjeguar se: *“Bazuar në kallëzimin e bërë nga denoncuesja dhe bashkëshorti i saj, i kallëzuar, gjatë procesit të plotësimit të kartelës mbi një pasuri të fituar në pronësi të kallëzuesve, ka kryer veprat penale të falsifikimit të vulave, stampave dhe formularëve, të parashikuara nga neni 190/3 i Kodit Penal dhe shpërdorimit të detyrës, të parashikuara nga neni 248 i Kodit Penal. I kallëzuar ka shtuar të tjerë bashkëpronarë, në kundërshtim me ligjin dhe duke falsifikuar formularin e aplikimit, sikur për të është paraqitur vetë kallëzuesja Zh. K.*

*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 8.10.2019, ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2017 ndaj të pandehurit.*

*Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. **, datë 5.2.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 8.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

Në këtë çështje, kam qenë në cilësinë e gjyqtarit relator dhe në këtë vendim kam qenë kundër vendimit të mësipërm dhe duke parashtruar qëndrimin tim në mendimin e pakicës. Kam arsyetuar se kërkesa e prokurorit për pushimin e kësaj çështjeje penale ndaj këtij të pandehuri, të dyshuar për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal është e pabazuar në prova dhe në ligj, pasi ky i pandehur e ka konsumuar edhe këtë veprë penale.....

Në zbatim të nenit 381 të Kodit të Procedurës Penale, si gjyqtar relator dhe duke qenë në pakicë ndaj vendimit të shumicës, arsyetimi i këtij vendimi është kryer nga një prej dy anëtarëve të tjerë të trupit gjykues.

*Sipas të dhënave të sistemit elektronik të Gjykatës së Apelit Vlorë, ky vendim është hedhur në sistem në datën 11.5.2020, pasi siç jeni në dijeni, pas datës 9.3.2020, u pezullua veprimtaria gjyqësore dhe me hyrjen në fuqi të Aktit Normativ nr. **, datë 25.3.2020 të Këshillit të Ministrave, kjo situatë vazhdoi dhe menjëherë pas rikthimit të situatës normale, nga sekretaria gjyqësore janë kryer veprimet përkatëse”.*

Komisioni, në lidhje me pretendimet e ngritura nga denoncuesi, vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse dhe të pranueshme.

3. Denoncim me nr. * prot., datë 4.3.2020, i depozituar nga znj. L. C**

Kjo shtetase ka depozituar denoncim për 5 subjekte rivlerësimi, ndërmjet të cilëve edhe për subjektin Sokol Ngresi. Rezulton se subjekti ka qenë njëri nga anëtarët e trupës (jo relator).

Denoncuesja ka shpjeguar se fillimisht trupi gjykues ka qenë i kryesuar nga z. N. T, i cili ka firmosur njoftimet për palët ndërgjyqëse. Më pas, në seancë ky relator u ka komunikuar palëve që shqyrtimi i çështjes ka kaluar në një tjetër trup gjykues, me kryesues z. P. A, i cili do të shqyrtojë çështjen.

Denoncuesja pretendon se pas njoftimit të palëve, përfaqësuesi i kësaj të fundit u paraqit në seancë edhe pa arsye ligjore edhe në arbitraritet procedural, trupi gjykues që në një seancë më parë me relator z. N.T, kishte vendosur kalimin e shqyrtimit të çështjes në tjetër trup gjykues (me relator P.A, sipas njoftimit të datës 13.6.2019) në seancën e datës 6.6.2019, doli me vendim të marrë në dhomë këshillimi “lënien në fuqi të vendimit nr. **, datë 25.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat”.

Denoncuesja ka depozituar fletëthirrjen për paraqitje në seancën e datës 6.6.2019, të nënshkruar nga z. N. T dhe për njoftimin e seancës së datës 13.6.2019, nënshkruar nga z. P. A.

Subjektit iu kërkua të jepte shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Në prapësimet e depozituara, subjekti ka shpjeguar se:

1. *“Siç rezulton nga përmbajtja e të dhënave elektronike të kësaj çështjeje, ajo është regjistruar për gjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë në datën 24.5.2019 dhe është shortuar elektronikisht në datën 27.5.2019, me gjyqtar relator N. T, i cili ka bërë planifikimin e gjykimit të çështjes në datën 31.5.2019.*
2. *Gjyqtari relator ka vendosur në datën 6.6.2019 që kjo çështje duhet t’i kalojë për shqyrtim trupit gjykues me gjyqtar relatorin P. A dhe anëtarë H. S dhe S.D, që kanë dhënë vendimin nr. ***, datë 26.9.2018, të kësaj gjykate, me të cilin është pranuar ankimi i kallëzueses kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal.*
3. *Ju bëj me dije se me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të bëra në Kodin e Procedurës Penale, me ligjin nr. 35/2017, që kanë parashikuar rishtaz institutin e gjyqtarit të seancës paraprake, për shkak të mosparashikimeve të shprehura në këto dispozita, fillimisht ka pasur një paqartësi nëse gjyqtari që ka shqyrtuar ankimin ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal duhej të vijonte edhe me shqyrtimin e kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes për gjykim, apo për pushimin e çështjes penale. Më pas, ky diskutim është zgjidhur, duke mbajtur qëndrimin se gjyqtari që ka shqyrtuar ankimin ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, konsiderohet si gjyqtar i hetimeve paraprake, i cili nuk mund të vijojë të gjykojë kërkesat si gjyqtar i seancës paraprake.*
4. *Në datën 7.6.2019 çështja është regjistruar me gjyqtar relatorin P. A dhe planifikuar për gjykim në datën 12.6.2019. Në këtë datë, gjyqtari relator P.A dhe anëtarët H. S dhe S. D, kanë dhënë dorëheqjen sepse kanë dhënë vendimin nr. ***, datë 26.9.2018 të kësaj gjykate dhe dorëheqja e tyre është pranuar.*
5. *Çështja është shortuar elektronikisht në datën 12.6.2019 te gjyqtarja K. Gj, shortim që, po sipas shënimeve elektronike të sekretares gjyqësore, është anuluar dhe çështja i ka kaluar manualisht gjyqtarit N. T, pasi ka marrë një vendim të ndërmjetëm si gjyqtar i vetëm.*
6. *Nga ky gjyqtar është bërë planifikimi i gjykimit të çështjes për shqyrtim në datën 13.6.2019.*
7. *Duke qenë në të njëjtin koleg me gjyqtarin N.T, kam marrë pjesë në shqyrtimin e kesaj çështjeje duke dhënë vendimin nr. ***, datë 13.6.2019.*

Në shqyrtimin e kësaj çështjeje unë nuk kam qenë gjyqtari që ka marrë pjesë në procedurat e njoftimit të palëve, por kam qenë vetëm në përbërje të trupit gjykues, ku bënte pjesë gjyqtari relator N. T, për shkak të pjesëmarrjes në të njëjtin koleg me këtë gjyqtar.

Të gjitha veprimet e njoftimit janë pjesë e përgjegjësisë së sekretarisë gjyqësore dhe mënyrës së planifikimit të çështjes nga gjyqtarët relatorë dhe çmoj se kanë qenë njoftimet e bëra nga sekretarja gjyqësore e gjyqtarit P.A për planifikimin e shqyrtimit të çështjes në datën 12.6.2019, që kanë konfunduar denoncuesen në lidhje me gjyqtarin relator.

Ndryshe nga sa pretendon denoncuesja në lidhje me mospjesëmarrjen, padijeninë e saj apo konfondimin e gjyqtarit relator, siç u evidentua edhe më lart, ky pretendim nuk rezulton i vërtetë pasi palëve të pranishme u është bërë i ditur shkaku i shtyrjes së seancës së kaluar dhe në këtë komunikim ka qenë e pranishme përfaqësuesja e saj.

Sipas nenit 329/b, pika 6 dhe nenit 329, pika 7, të Kodit të Procedurës Penale, ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë shqyrtohet në dhomë këshillimi, pra, pa praninë e palëve dhe vendimi përfundimtar u është shpallur publikisht palëve që kanë qenë të pranishme, pra edhe përfaqësueses së denoncueses”.

Komisioni, vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse dhe në përputhje me ligjin.

4. Denoncim nr. ** prot., datë 15.5.2019, depozituar nga z. A.Sh**

Pretendimet e ngritura nga ky denoncues i referohen 4 subjekteve rivlerësimi ndërmjet të cilëve dhe Sokol Ngresi. Denoncuesi pretendon se ka qenë në një konflikt gjyqësor pronësie me një palë tjetër. Duke qenë se nuk ka qenë dakord me vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka ankimuar vendimin. Denoncuesi pretendon që ka autorizuar përfaqësuesin e tij ligjor që të paraqesë ankim në emrin e tij, duke i dhënë edhe kompetenca të tjera përfaqësuesit. Denoncuesi argumenton që ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor të parashikuar në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata ka administruar ankimin dhe i ka dërguar palëve në gjykim kopje të tij. Gjykata nuk ka njoftuar ankuesin për të metat e ankimit (sikurse mund të ishte akti i përfaqësimit- prokura), brenda 5 ditëve, sipas parashikimeve ligjore. Pas disa seancave të kryera, gjykata ka vendosur me vendim të ndërmjetëm verifikimin e nënshkrimit të ankimit nga denoncuesi, i cili pretendon se ky vendim është i panevojshëm pasi përveç nënshkrimit prej tij, ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ishte nënshkruar gjithashtu edhe nga avokati i caktuar prej tij, i cili ka pasur tagra të plota përfaqësimi.

Denoncuesi pretendon se me këto veprime, gjykata, edhe pas 11 muajsh, vazhdon ta mbajë çështjen pa zgjidhje duke u shmangur nga gjykimi i themelit të çështjes me qëllim rrëzimin e ankimit nëpërmjet procedurës.

Subjektit iu kërkua të jepte shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se: “Gjykata e Apelit ka konstatuar se ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë është nënshkruar nga avokati me inicialet G. H., i cili ka përfaqësuar të paditurin A. Sh gjatë shqyrtimit të çështjes në shkallë të parë dhe në faqen e fundit të ankimit, në rekuizitën ‘Ankuesi’, evidentohet emri dhe mbiemri ‘Z. Sh’ (pra jo emri A. Sh) dhe nënshkrimi poshtë saj.

Duke iu referuar pjesës hyrëse të këtij akti procedural, ku pasqyrohet pala ankuese, evidentohet emri dhe mbiemri i të paditurit A. Sh dhe nga këto elemente, Gjykata e Apelit ka arsyetuar se rezulton e qartë që emri dhe mbiemri ‘Z. Sh’ poshtë rekuizitës ‘Ankuesi’ në faqen e fundit të ankimit, është një lapsus dhe jo falsifikim intelektual i këtij akti.

Në vijim, në lidhje me nënshkrimin e ankimit edhe nga avokati me inicialet G. H., gjykata e apelit ka konstatuar se atij nuk i ishte dhënë paraprakisht nga i padituri A. Sh tagri i nënshkrimit të këtij akti, ndaj ky subjekt ka vepruar si përfaqësues pa tagre. Këtë element të mungesës se tagrit të përfaqësimit edhe për të nënshkruar ankimin, gjykata e apelit e ka trajtuar në kuader të nenit 455 të Kodit të Procedurës Civile, si një e metë e ankimit për këtë pjesë të domosdoshme të vlefshmërisë së tij.

Në seancë gjyqësore, i padituri A. Sh, jo vetëm ka pohuar dijeninë e tij mbi ekzistencën e këtij akti, por ka miratuar, në kuptim të nenit 78 të Kodit Civil, dhënien e këtij tagri përfaqësimi avokatit, duke rikonfirmuar vullnetin e tij të plotë për ankimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe gjithë shkaqeve dhe kërtimeve të parashtruara në të.

*Në vijim, me kërkesën e palës tjetër është kryer ekspertimi i nënshkrimit të ankimit, nga eksperti i licencuar, nga ku rezultoi se ky ankim nuk ishte nënshkruar nga i padituri A.Sh. Bazuar në këtë provë, por edhe në të dhënat e sistemit TIMS ku evidentohen hyrje - daljet e të paditurit A. Sh nga territori i Republikës së Shqipërisë, gjykata e apelit e ka gjetur të provuar kërkimin e paditësit se akti procedural ‘ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë’, është i falsifikuar në pjesën e nënshkrimit në emër të shtetasit Z.Sh poshtë rubrikës ‘Ankuesi’, në këtë dokument, në faqen nr. ** të tij.*

*Por, më tej, gjykata e apelit, pavarësisht këtij konstatimi, bazuar në rrethanat e sipërcituara ku nënshkrimi i avokatit G. H është autentik dhe i padituri A. Sh ka miratuar në seancë gjyqësore (sipas kërkesave të neneve 455 dhe 456 të Kodit të Procedurës Civile) këtë veprim të përfaqësuesit pa një tagër të tillë të avokatit, gjykata e apelit ka çmuar se elementi i falsifikimit intelektual të këtij akti për pjesën e nënshkrimit në emër të shtetasit Z. Sh poshtë rubrikës ‘Ankuesi’, në këtë dokument, në faqen nr. ** të tij, nuk e bën këtë akt të pavlefshëm, aq më pak tërësisht të falsifikuar, duke vijuar kështu gjykimin e çështjes në shkallë të dytë mbi këtë ankim, mbi shkaqet dhe kërkimet e ngritura në të nga i padituri A. Sh ...”.*

Me vendimin nr. ***, datë 16.10.2019, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur prishjen e vendimit nr.***, datë 28.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Komisioni, në lidhje me pretendimet e ngritura nga denoncuesi, konstaton se shpjegimet e dhëna nga subjekti duken bindëse dhe të pranueshme, ndonëse formalisht është konstatuar mospërcjellja e dosjes organit kompetent, pasi ishte verifikuar një nënshkrim jo autentik i prokurës në fjalë, kjo rrethanë nuk e ka cenuar, në këndvështrimin substancial, gjykimin e kësaj çështjeje dhe nuk mund të passjellë pasoja.

Trupi gjykues, vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në prapësime, si dhe pasi kreu verifikimet në dosjet përkatëse dhe provat e depozituara nga subjekti, referuar pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se denoncimet nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e aftësive profesionale.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e gjyqtarit Sokol Ngresi dhe sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, propozon për kriterin profesional vlerësimin “i aftë”.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohej në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 11.12.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha